



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/11/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga Komuna e Glllogocit ndaj gjyqtarit J.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 26.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga Komuna e Glllogocit ndaj gjyqtarit J.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Komuna e Glllogocit përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.K, ankesë kjo e cila është dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 10.05.2024.

Parashtruesi i ankesës Komuna e Glllogocit ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit J.K, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale lidhur me lëndën C.nr.515/24, rrjedhimisht sipas tij Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc përmes aktvendimit me shenjë C.nr.515/24 të pranuar me datë 06.06.2024 e ka njoftuar Komunën e Glllogocit se nuk ka kompetencë për vendose të çështjes si dhe mos shfuqizim të aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurisë lidhur me propozimin e propozuesit të sigurimit S.S nga fsh. Korreticë e Poshtme, Komuna Drenas, sipas të cilit vendim të paditurës – kundërshtares së sigurimit i ndalohet ndërmarrja e çdo veprimi me të cilin do ti pamundësohet propozuesit të sigurimit shfrytëzimi i pronës publike para lokalit “Peshkopia” terasë e mbyllur në sipërfaqes S=151.60m² dhe terasë e hapur në sipërfaqe prej S=191.15m², zona kadastrale Glllogoc. Sipas parashtruesit të ankesës, brenda afatit të caktuar ka paraqitur ankesë ndaj aktvendimit të datës 13.05.2024 për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit e cila parashihet në bazë të Ligjit nr. 06/L-006 – LPK-së neni 306 par. 3 ku parashihet se pas mbajtjes së seancës nga paragrafi 2 të këtij neni gjykata me aktvendim të veçantë e anulon aktvendimin me të cilin e ka caktuar masën e përkohshme ose e zëvendëson me një tjetër aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit në pajtim me nenin 307 të këtij Ligji. Kundër aktvendimit të ri-caktimit të masës së sigurimit lejohet ankimi e që realisht gjykata nuk e ka bërë një gjë të tillë duke lënë në fuqi Aktvendimin e datës 13.05.2024 që i bie ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën

Kontestimore. Në fund, i ka propozuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës se në bazë të të lartcekurave të shqyrtojë ecurinë e procedurës.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se duke marrë parasysh natyrën urgjente të lëndës ka marrë veprimet e menjëhershme duke caktuar masën e përkohshme të sigurisë duke bërë edhe sigurimin e provës të lëmisë së ndërtimitarisë. Sipas tij, Kundërshtarja e sigurimit Komuna e Drenasit ka ushtruar kundërshtim dhe është caktuar seanca dëgjimore për të vendosur për masë të sigurisë, ku duke u bazuar në theksimet e palëve dhe shkresat e lëndës, marrë parasysh faktin se objekti i kontestit mes palëve ka të bëjë me çështje afariste ka vlerësuar se kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale – Shkalla e parë, andaj ka nxjerrë aktvendim për in kompetencë lëndore, ku palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit J.K.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për shkelje të ligjit a po për shkelje të detyrave të tij zyrtare si gjyqtar, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se pretendimet e parashtruara nga i njëjti mund të jenë pretendime për shkelje të procedurës kontestimore, ku në bazë të nenit 194 të LPK-së, Gjykata e shkallës së dytë e ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të ligjit.

Andaj, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës se tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës se pakënaqur ne Gjykatën e instancës me të lartë, e qe kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbej si kriter në vlerësimin e performancës së gjyqtarit të caktuar, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se nuk është kompetent dhe nuk ka të drejtën e komentimit të vendimeve të marra nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari i çështjes sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t’i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/11/24, me datë 26.06.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë